



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 1083/1 Prot.

Durrës, më 30.04.2026

V E N D I M

Nr. 64, Datë 30.04.2026

P Ë R

**"RIORGANIZIM NË MASËN NËN 20% TË PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË
TË STUDIMEVE MASTER I SHKENCAVE NË "MENAXHIM MARKETING",
PRANË FAKULTETIT TË BIZNESIT, UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU",
DURRËS"**

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; në VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar; në VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, "Për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; VKM-në nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; në Udhëzimin MASR Nr.1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisë kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar; në Udhëzimin e MAS Nr.2, datë 21.01.2025, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisë kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar"; në Statutin dhe në Rregulloren e UAMD-së; referuar shkresës së Fakultetit të Biznesit me nr. 839/2 prot., datë 20.04.2026, si dhe referuar relacionit nr. 839/4 prot., datë 30.04.2026 të Drejtorisë së Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Miratimin e riorganizimit në masën nën 20% të programit të ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në "Menaxhim Marketing", pranë Departamentit të Marketingut, të Fakultetit të Biznesit, në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Drejtoria e Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave për përcjellje në Ministrinë e Arsimit.
3. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Zv. Rektorët

- Drejtuesi i Njësisë Kryesore, FB
 - Drejtoria e Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave
4. Ky vendim hyn në fuqi për vitin akademik 2026-2027.

KRYETAR

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi

